



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-098

Prishtinë, më 4 mars 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 MARS 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Gonjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet një pikë shtesë.

Ai propozoi që pika 2.6 të hiqet nga rendi i ditës dhe këtë e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 25 dhe më 27 shkurt 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 25 dhe më 27 shkurt 2013

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 25 dhe më 27 shkurt 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy mbledhje plenare, dhe atë:

Seanca solemne, më 7 shkurt 2013, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 15-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Mbledhja plenare, më 8 mars 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit,
5. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2013,

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. *Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013*
2. *Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë*
3. *Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për debat parlamentar lidhur me raportet e institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë*

Kryesia, me kërkesë të kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, vendosi që tri kërkesat e lartshënuara për debat parlamentar të radhiten veç e veç në rend dite për mbledhjet plenare të radhës, që do të mbahen pas datës 8 mars 2013, sipas renditjes së mësipërme.

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012

Për raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012 diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit; Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së dhe Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit për ta përgatitur një informatë për mundësinë e vazhdimit të punimeve për ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në “Gërmi”.

5. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012

Kryesia e radhiti raportin e lartshënuar në rend dite për mbledhjen plenare, që do të mbahet më 8 mars 2013.

6. Kërkesa për rregullimin e statusit të mësimdhënësve në sistemin arsimor të Kosovës prej vitit 1990 deri në vitin 1999

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë kërkesën për rregullimin e statusit të mësimdhënësve në sistemin arsimor të Kosovës prej vitit 1990 deri në vitin 1999 dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

7. Njoftimi për formimin e Grupit punues joformal ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile

Nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e njoftoi Kryesinë lidhur me formimin e grupit punues joformal ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile. Ai sqaroi se kjo është një nismë e OSBE-së, në bashkëpunim me disa institucione të Shoqërisë Civile, me qëllim që të vendosen baza të institucionalizuara ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Kuvendit të Kosovës.

Qëllimi i formimit të këtij grupi është hulumtimi i praktikave të vendeve tjera dhe mënyrës si funksionon ky bashkëveprim ndërmjet Shoqërisë Civile me Kuvendin.

Për formimin e Grupit punues joformal ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit; Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së dhe Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së diskutimet e të cilëve janë dhënë në Transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për formimin e Grupit punues joformal ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile, konstatoi që për këtë çështje të diskutohet edhe një herë në njërën nga mbledhjet e radhës.

8. Njoftimi i Komisionit për Arsim lidhur me vizitën studimore të realizuar në Gjermani, prej 10 deri më 12 shkurt 2013

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Arsim, të realizuar në Gjermani, prej datës 10-12 shkurt 2013.

Pikat shitesë:

1. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për seancë solemne me rastin e 15-vjetorit të Epopesë së UÇK-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar për mbajtjen e një seance solemne, vendosi që më 7 mars 2013, në orën 12:00, të mbahet seanca solemne për nder të shënimit të 15-vjetorit të Epopesë së UÇK-së.

2. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë prej datës 19-21 mars 2013, të kryetarit të Asamblesë të Madhe Kombëtare të Turqisë, SH.T.Z. Cemil Çiçek dhe delegacionit të tij

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës së kryetarit të Asamblesë të Madhe Kombëtare të Turqisë, SH.T.Z Cemil Çiçek dhe delegacionit të tij në Kosovë, prej datës 19-21 mars 2013.

2. Të gjitha shpenzimet me rastin e pritjes së delegacionit të Turqisë, duke përfshirë akomodimin sipas parimit të reciprocitetit, drekave/darkave zyrtare, transportit të Kuvendit të Kosovës, si dhe shpenzimet tjera shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale